

SHIFRA E NXËNËSIT

PROVIMI I MATURËS

JANAR 2021

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

U D H Ë Z I M

KOHA PËR ZGJIDHJE TË TESTIT ËSHTË 180 MINUTA

Gjatë testit nuk lejohet përdorimi i mjeteve elektronike.

Nxënësi/nxënësja nuk guxon në asnjë mënyrë ta zbulojë identitetin e vet në test ose t'i drejtohet vlerësuesit në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Testi DUHET të shkruhet LEXUESHËM me laps kimik. Nxënësi/nxënësja mund të shkruaj me shkronja dore ose shtypi. Nëse shkruan me shkronja shtypi DUHET të theksojë shkronjën e madhe.

Testi përmban detyra të cilat zgjidhen në njërën prej mënyrave në vazhdim:

- duke rrethuar numrin para përgjigjes së saktë
- duke shkruar një përgjigje të shkurtër
- duke shkruar një përgjigje më të gjatë
- duke shkruar ese

Me testin ke marrë edhe **fletën e përgjigjeve** për detyrat me zgjedhje të shumëfishtë. Nevojitet që në vendin përkatës me kujdes të përshkruash përgjigjet tua.

Detyra do të vlerësohet me zero pikë nëse:

- është e pasaktë
- përgjigjja në detyrë me zgjedhje të shumëfishtë NUK është bart në fletën e përgjigjeve
- është rrethuar ose shkruar edhe përgjigjja e saktë dhe e pasaktë
- përgjigjja/eseja është e palexueshme dhe e paqartë
- përgjigjja/eseja është shkruar me laps të thjeshtë
- eseja NUK është shkruar në vendin e paraparë, por vetëm në faqet e parapara **për koncept** (shkrimi i konceptit nuk është i detyrueshëm)

Nëse gabon, vendos një vijë të kryqëzuar mbi të dhe detyrën zgjidhe përsëri. Kur ta përfundosh punën, kontrolloji edhe njëherë përgjigjet tua.

Me fat!



* A 1 0 9 1 0 8 3 *

FAQE E ZBRAZËT

Lexo tekstin dhe pastaj përgjigju në pyetjet 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6.

Nuk besonte në gjyqin e atyre që i ofruan para

PERELMAN, MATEMATIKANI I CILI I REFUZOI NJË MILION DOLLAR

I fshehur mes njerëzve të zakonshëm, ndërsa është në rrugë, ai përpiqet të mbetet pa u vënë re. Megjithatë, **Grigorij Jakovleviç Perelman** nuk është një banor i zakonshëm i Shën Petersburgut – ai është një gjeni i mistershëm i matematikës, i cili para më shumë se një dekade **Hipotezën e Poenkareovit**, një nga detyrat më të vështira matematikore të të gjitha kohërave.

Në verën e vitit 2006, kur prova e tij u konfirmua e saktë, Perelman e fitoi **Medaljen Fillds**, çmimin më të lartë në matematikë. Ndërkaq, ai e refuzoi çmimin, duke thënë se Shoqata Evropiane e Matematikanëve nuk është kompetente për të vlerësuar punën e tij, pavarësisht nëse vlerësimi është pozitiv.

Katër vjet më vonë, Instituti Amerikan „Klaj“ i ofroi atij një çmim milion dollarësh, i cili u shpall në vitin 1999 për zgjidhjen e secilit prej shtatë problemeve mijëvjeçare të matematikës. Mirëpo, pas një bisede telefonike me përfaqësuesit e Institutit, Perelman refuzoi shumën e ofruar, duke thënë: 'Unë nuk kam nevojë për asgjë. Kam gjithçka që dua'.

Edhe pse tërhoqi vëmendjen e mediave botërore, sot ai jeton i izoluar, duke u fshehur nga gazetarët. Fqinjët e Perelmanit pohojnë se bashkatdhetari i tyre gjenial jeton në kushte shumë modeste. Grigorij Perelman është një rus me prejardhje hebraike, i lindur më 13 qershor të vitit 1966. Ai fitoi një arsim cilësor matematikor në shkollën e famshme të matematikës në Shën Petersburg.

(përgatitur sipas tekstit të marrë nga <https://www.cdm.me/argëtim/kuriozite/perelman-matematikani-i-cili-i-refuzoi-një-milion-dollar>)

1. Përshkruaje titullin e tekstit.

.....
1 pikë

2. Teksti është shkruar:

1. me stilin administrativ
2. me stilin shkencor
3. me stilin publicistik

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë

3. Me çfarë Grigorij Jakovleviç Perelman tërhoqi vëmendjen e mediave botërore?

.....
.....

1 pikë

4. Nëse konstatimi është i saktë, rretho S, ndërsa nëse i pasaktë, rretho P dhe argumento përgjigjen.

KONSTATATIMI	SAKTË PASAKTË	ARGUMENTIMI I PËRGJIGJES
Perelmani e fitoi medaljen Fillds.	S P	

1 pikë

5. Si quhet problemi matematikor të cilin e zgjodhi Perelman?

.....
.....

1 pikë

6. A) Instituti Amerikan Klaj Perelmanit i ofroi një çmim prej një milion dollarësh në vitin:

1. 1966
2. 1999
3. 2006
4. 2010

Rretho numrin para përgjigjes së saktë.

1 pikë

B) Argumento përgjigjen.

.....
.....

1 pikë

Arkitektura e gjelbër

Njeriu parahistorik ndërtonte në mënyrë intuitive në harmoni me natyrën, kurse sot është në duart e projektueseve dhe investitorëve që të hartojnë, projektojnë dhe ndërtojnë “gjelbër”.

„Arkitektura e gjelbër“ nënkupton përdorimin maksimal të burimeve të ripërtëritshme dhe ekologjikisht të pastra të energjisë, konservimin dhe qarkullimin e serishëm të ujit dhe energjisë, përdorimin e materialeve natyrore dhe të riciklueshme në ndërtim, përdorimin e materialeve të kursimit të energjisë (izolimit, sistemit të ngrohjes), përdorimin e teknologjive të qëndrueshme (ekonomike dhe ekologjike), projektimin në harmoni me natyrën dhe hapjen e enterierit drejt ambientit, vendosjen e dialogut në mes të objekteve dhe rrethit arkitektonik me natyrën. Si rezultat i „projektimit të gjelbër“, u krijua „shtëpia e zgjuar“. Nga aspekti i qëndrueshmërisë së energjisë, ajo përdor burimet më të disponueshme dhe të ripërtëritshme të energjisë. Në vendin tonë, do të ishte uji gjeotermal, energjia e erës dhe energjia diellore. Kështu, ajo grumbullon dhe kursen energji, integron dhe kombinon sistemet energjetike, racionalizon konsumin përmes menaxhimit të programuar, kursen ujin, akumulon ujin e shiut, qarkullon sërish ujin, kontrollon cilësinë e ajrit në shtëpi dhe nivelin e emetimeve të dëmshme të gazrave nga shtëpia.

Ndërgjegjësimi për ndalimin e ngrohjes globale të planetit nga ndërtimet e dëmshme, filloi në gjysmën e dytë të shekullit njëzet, për ç’gjë u sollën disa deklarata (në konferencën e Komisionit Botëror të Mjedisit të Kombeve të Bashkuara në vitin 1986 dhe në Rio-de – Zhanejro në vitin 1992, Ekspozita Botërore Expo92 në Sevilja). Sot, arkitektët projektojnë sipas masës së njerëzve, por me vetëdijen e mbrojtjes së planetit nga ndotja e mëtejshme. UNESCO, lëvizje të ndryshme mjedisore të botës dhe shoqata arkitektonike japin çmime vjetore për projektet “më të gjelbra”. Vendet më të pasura ndërtojnë ndërtesat dhe vendbanimet më ekonomike. Qendra Botërore e Tregtisë në Bahrein është objekti më i madh, deri më sot, me burime të pavarura të ripërtëritshme të energjisë. Garazhi publik i Shtutgartit është një dëshmi se mund të projektohet “gjelbër”, madje edhe objekti i cili për nga dedikimi është më së paku ekologjik. Garazhi publik në qendër të Shtutgartit, krejtësisht në xham me një atrium qendror që siguron ventilimin natyral. Kopshti i brendshëm është i pasur me gjelbërim që shtrihet në të gjitha katet, shatërvanët, përrenjtë dhe pishinat krijojnë një mikroklimë të gjelbër dhe të shëndetshme brenda garazhit. Në krye të ndërtesës është një hapësirë për zyre me pamje nga rrethina – një koncept që dëshmon kujdesin për zyrtarin „e vogël“ që bën pagesën e parkimit. Kompleksi i gjelbër është duke u ndërtuar në Singapor dhe do të jetë një nga ndërtesat më të mëdha të banimit në biznes. Në Belgjikë, kohën e fundit, është prezantuar sistemi i ri i banimit studentor, i cili bazohet në tre parime: lëvizshmëri, privatësi të jetës studentore dhe dizajn ekologjik. Arkitektët, si material më të mirë për ndërtim, zgjodhën kontejnerët e vjetër për transport. Muret e kontejnerit janë të mbuluara me bimë të ndryshme dhe kanë të integruar panele diellore dhe mullinj me erë, kurse çdo njësi banesore lejon privatësi dhe qetësi më të madhe për studentët të cilët dëshirojnë të përqendrohen në mësimin pa shpërqendrim të jashtme.

(përgatitur nga ueb faqja [www.reciklirajte me.](http://www.reciklirajte.me))

7. Arkitektura e gjelbër është:

1. arti i ndërtimit të shtëpive
2. ndërtimi në harmoni me natyrën
3. ndërtimi i kopshteve vertikale

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë

8. Cilat janë burimet e ripërtëritshme të energjisë tek ne?

.....
.....

1 pikë

9. Në cilin vit është sjellë deklarata e parë për të ndaluar ngrohjen globale të planetit nga ndërtimet e dëmshme?

.....

1 pikë

10. A) Rretho numrin para objektit i cili është prova më e mirë se mund të projektohet “gjelbër” dhe objektin i cili për nga dedikimi i tij është më së pakti ekologjik.

1. Qendra Botërore e Tregtisë në Bahrain
2. Garazhi publik në Shtutgart
3. Kompleksi i gjelbër në Singapor

1 pikë

B) Argumento përgjigjen nën A.

.....
.....

1 pikë

11. Pranë emrit të personazhit shkruaj titullin e veprës letrare në të cilën paraqitet.

Tanusha

Ismena

Hektori

3 pikë

Bota kish ndërruar lisa,
Uji i ri në det
Kaltëronte n'ditn' e re;
Por lumbardha e Anakreontit
Në Temp rronte e moçme.
Nd'uj një dit' vate te mali
E s'u kthye si e kish zakon.
Veç që atë s'e thau bora,
S'e përgjaku heshtëza,
Po u largua gjersa ra
Tek e bardha shpia ime.
Kur n'agim tokë edhe shpi
U zbuluan bashkë me detin,
Si hareja që del sysh,
Më zgjoi duke fërfëlluar
Qelqeve t'dritares.
U patakta e ruajta jashtë:
Rrusht',pak aguridhe,
Dheut tonë i kishin hije;
Lule liu të hapura,
N'i tund era e i përzien,
Në atë ninull qeshin;
Si ato lule-qielli.
Ti vështroje dhe s'kujtoje
Asnjë mbëhi njerëzish.
Kallëzoret nëpër duajt
Po këndonin. Dheut huaj
Ahere ndër time motra
Kisha arritur; mëma ime
Emrin tim thosh nëpër shpi.
Një hare më rodhi kurmit,
Si hareja kur te shtrati,
Mbrëmanet,vajza e ngrohtë
Ndien për të parëzën
Sisët që m'i fryhen.

12.

A) Shkruaje emrin e veprës nga e cila janë shkëputur vargjet.

.....

1 pikë

B) Shkruaje emrin dhe mbiemrin e autorit të veprës nga e cila është fragmenti.

.....

1 pikë

13. Kush i thotë vargjet e dhëna?

.....

1 pikë

14. A) Cilit personazh i drejtohen vargjet?

.....

1 pikë

B) Përshkruaje ndonjë varg që e dëshmon këtë.

.....

1 pikë

15. Çfarë poeme është vepra nga e cila është shkëputur ky fragment?

.....

1 pikë

16. Ki kujdes në vargun e parë të theksuar të këtij fragmenti. Si quhet figura stilistike e përdorur në të?

1. anafora
2. epifora
3. metafora

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë

17. A) Shkruaj shkurtesat për fjalët:

1. e të tjera
2. Organizata Botërore e Shëndetësisë
3. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

2 pikë

B) Shkruaje numrin me shkronja.

717

1 pikë

Sapo u ngrit më këmbë mbi dysheme, iu afrua Bardhës që të sigurohej se po flinte; pastaj pa derën dhe pa se ishte mbyllur brenda. Iu afrua Bardhës lehtë-lehtë e pa e ndier. Fytyra e gruas së re vetëtinte nga bukuria; një hije e lehtë melankolie u jepte tipareve të saj diçka poetike dhe hyjnore... Por vështrimi i egër i shtrigës nuk u ndal në atë fytyrë të bukur, sytë e saj të ndezur flakë, si sytë e hienës, kërkonin kraharorin e Bardhës, atë kraharor të bardhë si alabastri, gjysmë të zbuluar e që një frymëmarrje e njëllojtë e ngrinte lehtë e me ngadalë.

Ajo nxori më në fund pistoletën e fshehur në përparëse, mbështeti tytën në zemrën e viktimës dhe hoqi këmbëzën. Arma u shkreh dhe bëri një zhurmë të mbytur. Dhoma u mbush me tym dhe me një erë squfuri. Kjo dhomë që kishte qenë dëshmitare e dhembjeve të një engjellusheje, u shndërrua në një shpellë skëterre, në një limer krimi e vrasjeje.

Bardha nuk bëri kurrfarë lëvizjeje, nuk lëshoi asnjë klithmë, ajo mbajti atë pozë që kishte marrë tek e kishte zënë gjumi; vetëm hapi sytë dhe për një çast i hodhi një vështrim të mekur xhelatit të vet.

Plumbi e kishte përshkruar tejprtej atë zemër të thjeshtë e të zjarrtë.

18. Shkruaje titullin e veprës nga e cila është shkëputur ky fragment, si dhe emrin dhe mbiemrin e autorit të saj.

.....
1 pikë

19. Cili është motivi kryesor në këtë fragment?

.....
1 pikë

20. Kujto ngjarjen e veprës në tërësi dhe zhvillo detyrën.

A) Rretho numrin para përgjigjes së saktë.

1. Bardha martohet me Lulin me dashuri dhe shkoi të jetojë në Temal.
2. Bardha martohet me Lulin pa dashuri dhe shkoi të jetojë në Temal.
3. Bardha martohet me Lulin pa dashuri dhe nuk shkoi të jetojë në Temal.

1 pikë

B) Argumento përgjigjen nën A duke theksuar fatin e Bardhës.

.....
.....
.....

2 pikë

21. Me cilën formë të shprehjes artistike është shkruar fragmenti?

1. monologut
2. dialogut
3. përshkrimit

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë

22. Një valë e vakët gëzimi po përpiqej ta pushtonte.

Gjeje rasën e emrit të nënvizuar dhe trego funksionin sintaksor të tij.

Rasa: _____

Funksioni _____

2 pikë

23. Në fjalinë e dytë të periudhës: *Tani janë bashkë, pas pak orësh mund të ndahen përjetë* – kallëzuesi i nënvizuar është:

.....

1 pikë

24. A) Rretho numrin para veprës e cila nuk bën pjesë në vargun e veprave të dhëna.

1. Albatrosi
2. Xha Gorio
3. Vdekja e Nositit
4. Juda Makabe

1 pikë

B) Argumento përgjigjen përse kjo vepër nuk bën pjesë në vargun e veprave të dhëna.

.....
.....

2 pikë

Në bazë të vargjeve të veçuara nga *Hanko Halla* e *Ali Asllanit*, dhe veprës në tërësi, zhvillo detyrat 25, 26, 27, 28 dhe 29.

Nuse e kësaj kohe tjetër zanat s'paska,
a do marr' kalemin, që të bëj laraska,
a do zër' të shkruaj' ose do dëgjojë
një kuti të vogël që na flet me gojë,
Një kuti të vogël që mos qoft' të jet',
është' frëng i marrë, çirret e bërtet!

Me një biz në dorë bën sikur punon,
këmbën përmbi këmbë nusja e dëgjon;
dhe çudi moj motër, si e qysh duron!
Duket nga një herë zëri e lëndon,
frëngu rri qetë ose do bërtas'
nusja e humbet dhe i vete pas,
frëngu e ngrë zërin dhe sokëllin
nusja e lë perin edhe vërshëllin;
ai flet me vete, flet e flet përçartë
nusja s'është' në vete, bunet më e zjarrtë!

25. Në bazë të fragmentit të dhënë cakto llojin letrar të cilit i përket kjo poezi.

.....

1 pikë

26. A) Nëse konstatimi është i saktë rretho S, ndërsa nëse nuk është i saktë rretho P.

Vargjet e veprës janë dymbëdhjetërokëshi.

S

P

1 pikë

B) Argumento përgjigjen nën A duke cekur mbështetjen e strukturës së tij.

.....
.....

1 pikë

- 27.** A) Hanko Halla e kupton absurditetin e sjelljes së vet vetëm kur shkon në Tiranë. Megjithatë ajo nuk di dhe nuk do t'i kërkojë falje vetë nuses por këtë e bën përmes:

.....
1 pikë

- B) Argumento përgjigjen nën A duke cituar vargjet karakteristike të cilat tregojnë për karakterin e pandryshueshëm të Hallës.

.....
1 pikë

- 28.** Nga strofa e parë përshkruaje vargun ku kemi intonacion thirrormor.

.....
1 pikë

- 29.** Shkruaje sinonimin për fjalën ÇIRRET.

.....
1 pikë

- 30.** Janë ofruar dy tema për hartimin e esesë. Rretho numrin para temës të cilën e ke zgjedhur dhe shkruaje esenë që duhet të ketë nga 250 deri në 300 fjalë.

Hartoje atë si një tërësi që duhet të ketë hyrjen, zhvillimin dhe përfundimin.

Respekto kërkesën për numrin e fjalëve +/-10% (vlerësohet punimi që ka 225 deri në 330 fjalë; nëse eseja ka më pak se 225 fjalë NUK LEXOHE FARE, kurse në fjalën e 330-të NDËRPRITET leximi). Eseja DUHET të shkruhet në fletët e parapara për shkrimin e esesë (eseja e shkruar në fletët e konceptit NUK LEXOHE).

Kij kujdes për saktësinë gjuhësore dhe që teksti të jetë i lexueshëm.

1. S'linda për urrejtje, por për dashuri (Antigona, Sofokliu)

Udhëzime për shkrimin e esesë:

→ Shkruaj cilës gjini letrare dhe cilit lloj letrar i përket vepra *Antigona*.

→ Trego për tiparet e karakterit të Antigonës.

- Sqaro për cilin veprim të saj vuan Antigona.
- Ceki dy personazhe të cilët i kontribuojnë fatit të Antigonës. Shpjego se si ata përcaktojnë fatin e saj.
- Në formë të përfundimit sqaro vargun: S'linda për urrejtje, por për dashuri.

2. Rëndësia e rrjeteve sociale në shoqërinë moderne

Udhëzime për shkrimin e esesë:

- Ceke një rrjet social që e konsideron më të popullarizuar sot dhe paraqit argumente për zgjedhjen tënde.
- Cilat janë arsyet më të shpeshta për përdorimin e rrjeteve sociale?
- Mbizotëron mendimi se të rinjtë kalojnë shumë kohë në rrjetet sociale. Jefe dhe argumentoje qëndrimin tënd për këtë.
- Rrjetet sociale mund të përdoren edhe për qëllimet arsimore. Shpjego si dhe jep një shembull.
- A munden të paraqesin rrezik rrjetet sociale? Kumto dhe argumento mendimin tënd për këtë.
- Kumto propozimin tënd/propozimet tua se çfarë të bëhet për t'u rritur përqindja e të rinjve që përdorin rrjetet sociale për qëllime arsimore.

25 pikë

1.				
2.				
3.				
4.				
5.				
6.				
7.				
8.				
9.				
10.				
11.				
12.				
13.				
14.				
15.				

0 1 2 3 4 5 6 7 8 9

1.				
2.				
3.				
4.				
5.				
6.				
7.				
8.				
9.				
10.				
11.				
12.				
13.				
14.				
15.				

0 1 2 3 4 5 6 7 8 9

1.				
2.				
3.				
4.				
5.				
6.				
7.				
8.				
9.				
10.				
11.				
12.				
13.				
14.				
15.				